

## Republika e Kosovës

### Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde- Ministry of Justice*

#### KOMISIONI PËR PËRZGJEDHJEN E NOTERËVE

Duke u mbështetur në nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë dhe në nenet 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2011 për Procedurën e Konkurrimit dhe Përzgjedhjen e Zyrave Noteriale, Komisioni për Përzgjedhjen e Notereve, pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, ka zhvilluar intervista me kandidatët që kanë aplikuar për zyra të lira noteriale në Republikën e Kosovës. Pas verifikimit përmes intervistës të kriterëve ligjore, siç janë përcaktuar në mënyrë të veçantë në nenet 9, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 03/L-10 dhe tutje detajuar në nenin 7, paragrafi 2, dhe nenin 8, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2011, **unanimisht** i dërgon Ministrisë së Drejtësisë listën e kandidateve që i plotësojnë kushtet e pranueshmërisë në Shërbimin Noterial dhe i rekomandon për emërim Ministrin të Drejtësisë si vijon:

1. **Për Prishtinë**, rekomandon z. Agon Vrenezi;
2. **Për Graçanicë**, rekomandon z. Adem Ademi;
3. **Për Lipjan**, rekomandon z. Zyfer Aliu dhe z. Fatmir Tasholli;
4. **Për Vushtrri**, rekomandon z. Ilmi Ademi;
5. **Për Klinë**, rekomandon z. Bedri Godnci;

6. **Për Gjilan**, rekomandon z. Hevzi Murseli;
7. **Për Ferizaj**, rekomandon z. Fejzullah Rexhepi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-010 për Noterinë si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2011 Për Procedurën e Konkurrimit dhe Përzgjedhjen e Zyrave Noteriale, edhe kandidat në vijim i plotësojnë kushtet për praninë në shërbim noterial. Megjithatë, për shkak të zyrave të limituara noteriale dhe konkurrencës së brendshme në mes të kandidatëve që kanë aplikuar për zyra noteriale, kandidatët e mëposhtëm vendosen në listën rezervë:

1. **Për Prishtinë**, rekomandon z. Zef Berisha dhe z. Jakup Hoti;
2. **Për Lipjan**, rekomandon z. Isa Gashi;


Ndërsa, duke u bazuar në nenin 4, paragrafin 3, nënparagrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterinë, kandidati në vijim nuk i plotëson kushtet për të ushtruar funksionin e noterit:

1. **Z. Agron Matjani**, aplikant për të ushtruar funksionin e noterit në Komunën e Prizrenit.

Prishtinë, 7 Mars 2014.


Anëtarët e Komisionit për Përzgjedhjen e Noterëve

Qerim Qerimi, kryesues




---

Ymer Hoxha, anëtar



---

Ramë Gashi, anëtar



---